



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:107547

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05368595

C.nr.804/2020

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Zenel Tasholli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L.B.. nga P., B. G. dhe L. G.nga fsh.D.. K.S..te cilët me autorizim i përfaqëson me A. G.. avokat në P.. rr”G...” nr.17/8 kati IV, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”S..” me seli në P..të cilën e përfaqëson B.. M.. me autorizim, me objekt kontesti shpërblim dëmi, me vlerë të kontestit 25,856.83€, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më datën 14.12.2023, në praninë e të t’autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 15.01.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve paditësve L.. B.. nga P., B.G.. dhe L.. G... nga fsh.D..K.S..dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve ”S..” me seli në P.. që paditësve paditësve L. B.. nga P., B. G..dhe L. G..nga fsh.D.. K.S.. për dëmin e pësuar në aksidentin e dt.15.06.2020, t’ia paguaj kompensimin për dëmin si në vijim:

1. Për paditësin L. B...

Në emër të dëmit jo material-moral t’ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej..... 1.200.00- €;
- Në emër të frikës të pësuar shumën prej..... 1,000.00.- €;

Në emër të dëmit material t’ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....**97.50.-€;**
- Në emër të shpenzimeve për mjekim shumën prej**52.00. -€.**

2. Për paditësin B. G...

Në emër të dëmit jo material-moral t'ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej.....2,500.00.- €;
- Në emër të frikës të pësuar shumën prej.....2,500.00.- €;
- në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,000.00.-€;
- në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 3% shumën prej.... 1,500.00.-€

Në emër të dëmit material t'ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej..... .97.50.-€;
- Në emër të shpenzimeve për mjekim shumën prej 619.03.-€.
- Në emër të shërimit klimaterik-fizioterapeutik120.00.-€.

3. Për paditësin L. G...

Në emër të dëmit jo material-moral t'ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej..... 1,200.00.- €;
- Në emër të frikës të pësuar shumën prej..... . 1,000.00.- €;

Në emër të dëmit material t'ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....**97.50.-€;**
- Në emër të shpenzimeve për mjekim shumën prej**12.00.-€**

Të gjitha këto shuma në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, këto me kamatë ligjore prej 8% e cila fillon të rrjedhë :per demin jo material per shkak te dhimbjeve shpirtërore kamata ligjore rrjedh nga data e marrjes se këtij aktgjykimi 14.12.2023, ndersa per kategoritë tjera te demit materila kamata ligjore rrjedh data e parashtrimit te padisë dt:03.09.2020, e te gjitha keto gjerë në përmbushjen perfundimtare të detyrimit, nën kërcënimin e përbarimit.

II.DETYROHET e paditura t'ia paguajë paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 5,036.00.-€, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, si e pabazuar, e poashtu refuzohet kërkespadia e

paditësve sa i përket kompensimit në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe kompensimit në emër të rehabilitimit fizioterapeutik ,si e pabazuar.

-

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit, përmes të autorizuares së tyre, kanë kërkuar parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.04.11.2016, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..” me seli në P.., me objekt kontesti kompensim dëmi.

Në padi ka theksuar se me dt. 15.06.2020 në magjistralen Ferizaj-Prishtinë ka ndodhur aksident komunikacioni në mes të automjetit A e tipit “VW P..” e siguruar te KS “S..” dhe automjetit”VW G...”, deri te aksidenti ka ardhur kur drjtuesi i automjetit A nuk e respekton shenjen Stop dhe kyqet ne magjistrale në mënyrë të pasigurt, pastaj goditet nga vetura B e cila ishte në lëvizje në drejtim Ferizaj-Prishtinë, e me këtë rast lëndime trupore pëson paditësi Labinot Buqaj në cilësinë e vozitësit dhe paditësit B. G..dhe L.. G..në cilësinë e pasagjerëve në veturë.

Me parashtrësë ka bërë precizimin e kërkespadiisë së paditëseve, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që paditësve, e paditura t’ju kompensoj për dëmin e pësuar ne aksidentin e dt.15.06.2020, dhe ate për paditësin L.. B..emër të dhimbjeve fizike-trupore shumen prej 2500€, në emër të frikës së përjetuar shumen prej 2.000€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumen prej 210.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 140.00€, në emër të shërimit klimatik-fizioterapeutik shumen prej 182.00, në emër të shpenzimeve të shërimit -mjekimit sipas faturave shumen prej 52.00€. Për Paditësin B..G.. ka kerkuar në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumen prej 3.500€, në emër të frikës së përjetuar shumen prej 3.500€, në emër të shëmtimit trupor shumen prej 1.500€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 3% shumen prej 1.500€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumen prej 210.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 140.00€, ne emër të shërimit klimatik – fizioterapeutik shumen prej 182.00€, në emer të shpenzimeve të mjekimit shumen prej 619.03€. Për paditësin L.. G.në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumen prej 2.000€, në emër të frikës së përjetuar shumen prej 1.500€, emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumen prej 210.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 140.00€, ne emër të shërimit klimatik – fizioterapeutik shumen prej 182.00€, në emer të shpenzimeve të mjekimit shumen prej 12.00€.

Gjithashtu në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditësve ka deklaruar se mbesne teresi prane deklarimeve si ne seancat e kaluara si dhe ne kete seance, meqenese baza juridike e padise dhe kerkespadise pjeserisht ka qene kontestuese nga e paditura konsiderojme se pas nxjerrjes se proves me ekspertize nga eksperti V.B.. si dhe nxjerrjes se proves me superekspertize nga grupi i eksperteve te komunikacionit rrugor, eshte provuar mjaftueshem se paditesit nuk kane kontribuar ne pasojat dhe vellimin e demit ne kete aksident te komunikacionit te dt. 15.06.2020. Ne baze te kesaj kemi bere edhe parashtresen per precizimin e kerkespadise ne te cilen kemi specifikuar shumat per secilin padites, kemi nje ndryshim tek pika 2 e aktgjykimit qe do te thote se shuma e pergjithshme per pagese duhet te jete 25,856.83€. I ka propozuar gjykatës që kërkespadinë e precizuar të paditësve ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedures i ka kërkuar në shumë prej 4,076.80€, dhe ate per perpilimin e padise ne shume prej 416.00€, per perpilimin e parashtreses per precizimin e kerkespadise per tre padites ne shume prej 416.00€, si dhe ne emer te perfaqesimeve per 3 padites per 6 seanca te mbajtura shumen prej 3,244.80€, me konkretisht per nje seance per 3 padites eshte shuma 540.80€ x 6 seanca 3,244.80€, për ekspertizat mjekesore ne shume prej 750.00€, ekspertizat e trafikut rrugor ne emer te ekspertit V..B.. 50.00€, per perpilimin e superekspertizes nga grupi i eksperteve ne shume prej 600.00€, pagesen per takse ne padi ne shume prej 101.00€.

I autorizuari i të paditurit deklaron: Me adminstrimin e provave ne teresi e veq e veq, e paditura konsideron se baza juridike e kerkespadise u vertetua pjeserisht. Sa i perket vleres se kerkespadise une sot ne kete seance pranova parashtresen e paleve paditese me precizim te kerkespadise, te cilen pjeserisht e kontestoj sa i perket bazes juridike per shkak se konsiderojme se ekziston ndarja e pergjegjesise – kontributi i pjesemarresve ne ket aksident trafiku. Kjo eshte vertetu me ekspertizen e punuar nga eksperti B.. A..dhe nuk eshte vertetu ne menyre te plote nga grupi i eksperteve per shkak se mendimin dhe konstatimin grupi i eksperteve e ka sjelle ne baze te nje dokumenti i cili nuk eshte dash ti falet besimi – eshte dokument subjektiv. Sa i perket vleres se precizuar te kerkespadise, konsideroj se jane teper te larta per gjitha format dhe llojet e demeve te kerkuara per secilin padites, jane ne kundershtrim me mendimin dhe konstatimin e eksperteve mjekesor per demtime te pesuara si pasoje e aksidentit te trafikut, prandaj i propozoj gjykates qe vlerat e precizuara mbi oferten qe do ta ofroj ne kete fjale përfundimtare per secilin padites ti refuzoj si te pabazuar.

E paditura në përgjegje në padi ka deklaruar se e konteston padinë për nga lartësia e saj, ndërsa sa i përket bazës juridike do të deklarohe në seancë.

Përfaqesuesi me autoriam i të paditures në seancen e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklarua se për paditesin L.. B., e paditura ofron shumen prej 1,000.00€, ne

emer te lendimeve te lehta trupore, ndersa sa i perket kerkesave per deme materiale siq jane ndihma kujdesi i huaj, ushqimi i perforcuar, sherimi klimatik etj. nuk jane te provuara me prova materiale, per çka i ka propozuar gjykatës qe te njejtat te refuzohen. Për paditesit B..G., per gjitha format dhe llojet e demit ofrojme shumen prej 3,000.€, mbi kete shume gjykates i propozojme qe padine dhe kerkesen per te njejtin ta refuzoj si te pabazuar, poashtu te refuzohen kerkesat per demin material te precizuar si ne parashtrese, ne mungese te provave, ndërsa për paditësin L. G..poashtu ka ofruar shumen prej 1,000.00€ ne emer te lendimeve te lehta trupore, mbi kete shume i ka propozuar gjykates qe padine ta refuzoj si te pabazuar, poashtu gjykates i ka propozuar qe te refuzohen kerkesat per demet materiale siq jane kudesi, ndihma etj, per mungese te provave.

Ka shtuar se e kundërshton precizimin e kerkespadise sa i përket kamates duke u bazuar ne qendrimin e Gjykates Supreme te Kosoves se kamata duhet llogaritur nga dita e aktgjykimit e jo nga dita kur eshte ushtruar padia. Ndërsa sa i përket shpenzimeve te precizuara te procedures kontestimore, gjykates i propozoj te ketë parasysh me rastin e vendosjes parimin e suksesit ne procedure. I ka propozuar gjykatës kumulativisht mbi shumat e ofruara per te gjithë paditësit, padinë dhe kërkesen e saj ta refuzoj si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: letërnjoftimi i paditësit Labinot Buqaj, nr. 896400(kopje), raporti i aksidentit 2020-AR-..., dt. 15.06.2020, raporti i Klinikës Emergjente nr. 29906, dt. 15.06.2020, raporti emergjent ne emer te L. B., dt. 15.06.2020, lëshuar nga SHSKU-QKUK, Prishtinë, raporti specialistik per paditesin L.. B..26.10.2020, lshuar nga Klinika L.. Prishtinë, letërnjoftimi i paditesit B.. G..nr. 015858, raportet mjekesore, raporti i Ordinancez fizioterapeutike per paditesin B.. G., dt. 04.07.2020, kupona fiskal (tri faqe kopje), letërnjoftimi i paditesit L..G.. nr.916960, konstatimi radiologjik dt. 17.06.2020, me raporte tjera mjekesore, libreza e qarkullimit me nr. 1077289, polica e sigurimit nr.208875, fotot e automjetit te demtuar(dy faqe), Akt-Ekspertize demi per automjetin me targat ...-LP, fotot e paditesit B.. G..(3 faqe), fotot e automjetit te aksidentuar te tipit G., dt. 16.05.2020 (1 faqe), pergjigja ne padi C.nr.804/20, dt. 20.04.2022, Ekspertiza e komunikacionit e ekspertit Visar Bagjuku, dt. Janar 2023, ekspertiza e ekspertëve mjeksor dr. V..Sh., ORL, dr. S.S..u, Ortoped- Traumatolog, dr.S..B.– psikiatër, procesverbali C.nr.804/20, dt.09.03.2023 ne te cilin kane qene prezent ekspertet mjekesore si dhe eshte deklaruar dhe sqaruar eksperti i komunikacionit V.. B., ekspertiza e ekspertit te komunikacionit B..A., dt. 17.03.2023, ekspertiza e grupit te eksperteve B.L., V. H.dhe Rr.. S., dt. 20.10.2023 , parashtresa pergjigje per rastin 202....., lëshuar nga Njesia

Rajonale e Komunikacionit Rrugor, Procesverbali C.nr.804/20, dt.21.11.2023, ne te cilen eshte deklaruar perfaqesuesi i grupit te eksperteve B. L., parashtresa për precizimin e kërkesëpadisë C.nr.804/20, dt.20.11.2023.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Gjykata me propozimin e të autorizues së paditsve ka bërë nxjerrjen e proves me ekspert nga lëmia e komunikacionit. Nga ekspertiza e komunikacionit e ekspertit V.B.. e përpiluar me shkrim me dt.06.01.2023, i cili ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e kyqjes së pasigurt në rrugën nacionale nga rruga dytësore e drejtuesit të automjetit Passat.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të të paditues ka bërë nxjerrjen e ekspertes nga lëmia e komunikacionit. Nga ekspertiza e komunikacionit e ekspertit B..A.. te dt.12.03.2023, të përpiluar me shkrim, në medimin e dhënë ka konstatuar se drejtuesi i automjetit A duke marrë veprim në kyqje nga rryga dytësore(shenja Stop) për rrugën kryesore, pa e verifikuar paraprakisht komunikacionine atë pjesë të rrugë duke mos e respektuar përparsinë e kalimit ndaj automjetit B shkakton aksident komunikacioni rrugor. Me këtë rast drejtuesi i automjetit B ka lëvizur me shpejtësi me te madhe se shpejtësia e lejuar në atë pjesë të rrugës , drejtuesi i automjetit B e ka kontribuar në rritjen e pasojave dhe vëllimin e dëmit.

Eksperti i komunikacionit ne seancen e dt.27.04.2023, ka sqaruar se drejtuesi i automjetit B ka lëvizur me shpejtësi të madhe se shpejtësia e lejuar në atë pjesë të rrugës, në zonën ku kufizimi i shpejtësisë(shifranikut të plotësuar) nga Policia që është E e që nënkupton 50km/h e i njëjti ka lëvizur me shpejtësi 74.12km/h, andaj mbi bazën e kësaj shpejtësia me të cilën ka lëvizur drejtuesi i automjetit B e ka kontribuar në rritjen e pasojave dhe vëllimin e dëmit.

Me propozimin e të autorizues së paditësve, gjykata ka bërë nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit , të përpiluar me shkrim me dt.20.10.2023, nga grupi i ekspertëve ing.B. L., ing V.H..dhe ing.Rr.. S., të cilët ne mendimin e dhënë kanë konstatuar se ky aksident i komunikacionit rrugor nuk do të vinte oqëse shiferi i automjetit A para hyrjes në udhëkryq të ndalej para shenjës Stop(që e kishte për detyrim) me ç'rast do të mund a vërente shoferin në automjetin B i cili po lëvizte në rrugën me përparësi kalimi e që po vinte nga ana e majtë e tij. Shoferi me automjetin B(VW G...) me shpejtësinë me të cilën lëvizte(41 km/h) e cila është brenda asaj kohe të kufizuar, nuk ka pasur mundësi teknike të evitimit të këtij aksidenti. Andaj te nejtit, kanë ardhë në përfundim se aksidenti i komunikacionit rrugor është shkaktuar me lëshimet e shoferit të automjetit A(VW P..) me veprimet e tij: mosrespektim i shenës Stop-para

hyrjes në udhëkryq dhe mosrespektim i përparësisë së kalimit ndaj automjetit B. Në këtë rast shoferi i automjetit B(VW G..) nuk ka lëshime në këtë aksident.

Në seancen e dt.21.11.2023 eksperti i komunikacionit B.. L..., nga grupi i eksperteve ka sqaruar se ashtu siq e kemi elaboruar ne ekspertize shenje mbi kufizimin e shpejtesise bazuar sipas drejtimit te levizjes se automjetit B nuk ka pasur, ndersa nga drejtimi i kundert P..-F.. para udhekryqit eshte e vendosur shenja 50km/h. Metutje ka shtuar se bazuar ne raportin fillestar te policise me nr. 2020-AR..., kufizimi i shpejtesise qendron 50km/h. Pas daljes ne teren dhe pergjigjes shtese qe kemi pranuar nga ana e policise eshte vertetuar se shiqar sipas drejtimit te levizjes se automjetit B nuk ka patur shenje mbi kufizimin e shpejtesise me ç’rast vlejne rregullat e përgjithshme te trafikut, ku kufizimi maksimal i lejuar ne rruge nacionale eshte 80km/h. Bazuar ne kete nuk ka kontribut shoferi i automjetit B ne shkaktimin apo pasojat e ketij aksidenti.

Në seancen e dt.14.12.2023, përmes dëgjimit dhe ballafaqimit të ekspertëve te komunikacionit dhe ate ekspertit B..A..si dhe dy anetareve te grupit te eksperteve V.H.dhe Rr.S..., duke u ballafaquar lidhur me mendimet dhe konstatimet e dhena sa i perket shkaktarit te aksidentit te dt. 15.06.2020, dhe kontribuesit eventual ne kete aksident.

Eksperti V.. H.. –nga grupi i eksperteve ka deklaruardeklararon ne si grup i eksperteve jemi bazu ne shkresat zyrtare te cilat i posedojme, gjithashtu kemi bashkangjit prove deshmi shtese te leshuar nga Organi Kompetent – Policia e Kosoves, i dt. 15.08.2023, ku Policia e Kosoves deklararon ne raport shtese zyrtar qe kufizimi i shpejtesise ne raportin e policise fillestar ka qene nje gabim teknik, sa i perket pyetjes se kush eshte kompetent ne rregullimin e sinjalistikes vertikale dhe horizontale kompetent eshte Ministria e Infrastruktures ku sipas te ciles me nje distance prej 800m, ndodhet sinjalistika e cila perkufizon kufizimin e shpejtesise se levizjes prej 80km/h, prove shkresat ne ekspertize, faqja 5.

Eksperti i komunikacionit B..A.. ka sqaruar se kam qene ne vendin e ngjarjes siq e kam cekur ne pike 2.8, fq.5, poashtu kam theksuar qe ne nje distance me te larget ndodhet kufizimi i shpejtesise 80km/h, nuk i kam matur), mirepo eshte ne nje distance me te larget, nese analizojme vendin ku ka ndodh aksidenti prape e ritheksoj qe kufizimi i shpejtesise prej anes se Prishtines ne drejtim te Ferizajit eshte e vendosur me shenje prej 50km/h dhe nuk ka kuptim as ne aspektin e projektimit te rrugeve, as ne aspektin e sigurise dhe as ne ate praktik qe te ndodhe qe nga ana tjetere te kete kufizim ndryshe nga ajo ane qe eshte e saktuar me kufizim nga drejtimi i Prishtines ne drejtim te Ferizajit ne nje distance te afert eshte e vendosur kufizimi prej 50km/h, kurse nga ana e kundert mungon ky kufizim.Ka shtuar se ne raportin fillestar policor duke u bazu ne shifranikun e anes se majte shkronja perkufizuese e shpejtesise eshte shkronja E, e cila ne gjuhen e komunikacionit nenkupton shpejtesine prej 50km/h.

Poashtu kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kërkesëpadisë të precizuar me parashtrësën e datës 20.11.2023.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësve, në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. S. S.-Ortoped-Traumatolog, dr.V.. Sh..ORL dhe Dr.S.. B..-psikiatër, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit B.. G.. lidhur me natyrën e lëndimeve trupore, kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës së punuar me shkrim , ku sipas tyre paditësi në aksidentin e komunikacionit te dt:05.07.2016 ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë trupore, paditësi L.. G..ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe paditësi L..B..ka pësuar lëndime të lehta trupore. Të nejtit kanë prezentuar në sencen e dt.09.03.2023, mirpo nuk ka pasur pyetje dhe vrejte nga përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

1.-Me këto prova të administruara gjykata për paditësin **L.. B..**në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën në shumën prej.. 1,200.00.-€ dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësit sipas mendimit të ekspertit mjekësor në ekspertizen e dt.22.02.2019, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar lëndime që klasifikohen si lëndime të lehta trupore, në momentin e pësimit te lëndimit klasifikohen si dhimbje fizike të intensitetit posaqërisht të lartë që kanë zgjatur disa sekonda, dhimbje fizike te intensitetit te lartë që kanë zgjatur për 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 2 javë dhe dhimbje fizike me intensitet të ulët që zgjasin edhe për 2 javë të tjera .

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00.-€ dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë dr.S..B.., paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 48 orë që është manifestuar me simptoma te ankthit të gjeneralizaurfrikë nga invaliditeti, frikë nga procedurat mjekësore, pagjumësi, frikë sekondare te intensitetit të mesëm dhe më të ulët që ka zgjatur prej 3-4 muaj, e cila është e përcjellur me ankth, pagjumësi , zgjime të herë pas hershme gjatë natës dhe pasiguri për pjeësmarrje në komunikacion.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 97.50-€, duke u nisur në baza ditore të cilën gjykata e llogariti në shumë prej 6.50 euro në ditë, ashtu që sipas mendimit te ekspertit te ortopedisë të njëjtit i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 2 javësh.

Në emër të shpenzimeve të shërimit gjykata ia ka njohur shumën prej 52.00€, e kjo bazuar në fakturat dhe kuponat fiskal.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe në emër të shërimit klimaterik-fizioterapeutik gjykata refuzoi në tërësi si tëpa bazuar në mungesë të vërtetimit të dëmit material me prova materiale, fatura dhe sipas mendimit të ekspertëve mjekësorë të cilët nuk e kanë parapa fare këtë lloj dëmi për paditësin.

2.- Me këto prova të administruara gjykata për paditësin **B. G.** në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën në shumën prej.. 2,500.00.-€ dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësit sipas mendimit të ekspertit mjekësor në ekspertizen e dt.22.02.2019, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar lëndime që klasifikohen si lëndime të rënda trupore, në momentin e pësimit të lëndimit klasifikohen si dhimbje fizike të intensitetit posaqërisht të lartë që kanë zgjatur 30minuta, dhimbje fizike të intensitetit të lartë që kanë zgjatur për 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 3 javë dhe dhimbje fizike me intensitet të ulët që zgjasin edhe më tej gjatë motit të ftohtë, pezmatimeve të hundës, infeksione të ndryshme.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2,500.00.-€ dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë dr.S.B..., paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda që është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcnim integritetit trupor, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 48 orë që është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, frikë nga procedurat mjekësore, pagjumësi, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe më të ulët që ka zgjatur prej 3-4 muaj, e cila është e përcjellur me ankth, pagjumësi, zgjime të herë pas herë gjatë natës dhe pasiguri për pjeësmarrje në komunikacion.

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor gjykata ia ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,500.00.-€, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë nga fakti se nga ekspertiza mjekësore, paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithëshëm jetësor prej 3% .

Në emër të shëmtimit trupor të pësuar gjykata ia ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00.-€, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë nga fakti se nga ekspertiza mjekësore paditësi ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së lehtë për shkak të ngriturës në shpinën e hundës me madhësi të kokrrës së misrit dhe formë të rrumbullakët si pasojë e thyerjes.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 97.50-€, duke u nisur në baza ditore të cilën gjykata e llogariti në shumë prej 6.50 euro në ditë, ashtu që sipas mendimit të ekspertit të ortopedisë të njëjtit i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 2 javësh.

Në emër të shpenzimeve të shërimit gjykata ia ka njohur shumën prej 619.03€, e kjo bazuar në fakturat dhe kuponat fiskal.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj , gjykata refuzoi në tërësi si të pa bazuar në mungesë të vërtetimit të dëmit material me prova materiale,fatura dhe sipas mendimit të ekspertëve mjekësorë të cilët nuk e kanë parapa fare këtë lloj dëmi për paditësin.

3.- Me këto prova të administruara gjykata për paditësin **L. G.** në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën në shumën prej. 1,200.00.-€ dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësit sipas mendimit të ekspertit mjekësor në ekspertizën e dt.22.02.2019, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar lëndime që klasifikohen si lëndime të lehta trupore, në momentin e pësimit të lëndimit klasifikohen si dhimbje fizike të intensitetit të lartë që kanë zgjatur për 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 2 javë dhe dhimbje fizike me intensitet të ulët edhe për 1 javë tjetër.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00.-€ dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë dr.S..B., paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda që është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcnim integritetit trupor, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24 orë që është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, shqetësim, jostabilitet emocional, frikë primare të intensitetit të mesëm dhe më të ulët që ka zgjatur prej 2-4 muaj, e cila është e përcjellur me ankth, pagjumësi , zgjime të herë pas herëshme gjatë natës dhe pasiguri për pjeësmarrje në komunikacion.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 97.50-€, duke u nisur në baza ditore të cilën gjykata e llogariti në shumë prej 6.50 euro në ditë, ashtu që sipas mendimit të ekspertit të ortopedisë të njëjtit i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 2 javësh.

Në emër të shpenzimeve për shërim gjykata ia njohi shpenzimet në shumë prej 12.00-€, e kjo bazuar në urdhërpagesat dhe kuponët fiskal.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe në emër të shërimit klimaterik-fizioterapeutik gjykata refuzoi në tërësi si të pa bazuar në mungesë të vërtetimit të dëmit material me prova materiale,fatura dhe sipas mendimit të ekspertëve mjekësorë të cilët nuk e kanë parapa fare këtë lloj dëmi për paditësin.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit ia dha besimin e plotë ekspertizës së dt.31.01.2023 nga se kjo ekspertizë i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore pasi e

njëjta është e punuar nga 3 ekspertë mjekësor e të cilët vlerësuan të cilët kanë dhënë mendimin e tyre sa i perket dëmeve të pësuarra për paditësit në aksidentin e dt.15.06.2020 .

Baza ligjore

Gjykata, nisur nga konstatimi i gjendjes faktike të përshkruar si më lartë, gjeti se paditësit duhet zhdëmtuar mbi bazën e përgjegjësisë, në bazë të nenit 159, par. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet “***Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit***”, dhe meqenëse automjeti A-Audi A 3 me targa 05-959-BE, ishte i siguruar te e paditura, atëherë mbi bazën e sigurimit nga autopërgjegjësia, gjykata aplikoi nenin 918 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në të cilin përcaktohet” ***Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër***”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kompensimit të caktuar si në pikën I të dispozitivit, iu referua dispozitave mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material të përcaktuara në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet” ***Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla***”.

Gjykata sa i përket dëmit jo material të përcaktuar iu referua 183, par.1 përcaktohet “ ***Për dhembjet e pësuarra fizike, për dhembjet e pësuarra shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material***”, ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet “***Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror***”. poashtu me nenin 184, par.1 të LMD-se parashihet “***Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore***”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Prandaj, gjykata, nisur nga arsyet e cekura ligjore, mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike, gjeti se paditësëve i takon kompensimi i dëmit material dhe jo material si ne pikën I te dispozitivit, duke vlerësuar se shumtat e gjykuara janë të mjaftueshme, koherente me natyrën, kohëzgjatjen, intensitetin e dëmeve materiale dhe jomateriale që paditësit kanë pësuar në aksident komunikacioni për të gjitha kategoritë e dëmeve.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kompensimit të caktuar si në pikën I te dispozitivit, iu referua dispozitive mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material të përcaktuara në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet “*Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla*”, ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet “*Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Ndërsa me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*. Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se *Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*.

Lidhur me kamatën e aplikuar, gjykata iu referua nenit 382, par.1 të LMD-se në të cilin përcaktohet detyrimi i debitorit që vonon përmbushjen e detyrimit në të holla dhe lartësia e kamatëvoneses ku përcaktohet “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, ndërsa par.2 i këtij neni përcakton “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, ndërsa rrjedhjen e kësaj kamate e përcaktoi në dy periudha kohore, duke marrë për bazë edhe praktiken gjyqësore, ku përcaktohet se për demin material kamavonesa rrjedh nga data

e nxjerrjes se aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa kamatvonesa për demin material rrjedh nga koha e ushtrimit të padisë në rastin konkret, duke iu referuar nenit të cekur më lartë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumën e aprovuar, gjykata të njëjtat i refuzoj nga se konsideroj se shumën e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarve të sillet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues.

Gjykata, lidhur me pjesën refuzuese sipas kërkesëpadisë nga pika **III** e dispozitivit, iu referua provave në shkresat e lëndës, natyrës, kohëzgjatjes dhe intensitetit të lëndimeve dhe dëmeve të pësuar nga paditësit, standardit shoqëror në të cilin jeton paditësja, praktikës gjyqësore në rastet e aplikimit të këtij dëmi, e poashtu për dhimbjet shpirtërore të pësuar të paditësve, ashtu edhe me aprovimin eventuale të saj, gjykata do të vuhej në shërbim të keqpërdorimit me qëllime lucrative të paditësve dhe palëve të autorizuara për tu zhdëmtuar në shpërpjesëtim të hapur me dëmet e pësuar, andaj, mbi bazën e këtyre arsyeve këtë pjesë të kërkesëpadisë e refuzoi si të pabazuar, e poashtu refuzoi kërkesën e paditësve për rehabilitim fizioterapeutik në mungesë të provave materiale, dhe kërkesën për kompensimin në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, pasi që nga ekspertiza mjekësore e dt.31.01.2023, përkatsisht e ekspertit ortoped Sabit Sllamniu, nuk është paraparë se paditësit të kenë pasur nevojë për kujdes dhe ndihmë nga personi tjetër.

Gjykata në këtë rast ka vlerësuar edhe thëniet e palës së paditur ku e njëjta nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por vetëm e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë së precizuar, mirëpo as një provë nuk është argumentuar e kundërta nga ajo që është në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me arsyetimet e dhëna më lartë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartin shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 416.00-€ (për tre paditës), për parashtrësë për precizim të kërkesëpadisë shumën prej 416.00-€, për 5 seanca të mbajtura nga 540.80x5=2.704€, për 3 ekspertiza mjekësore shumën prej 750.00-€, për ekspertizë 50.00€, për superekspertizë nga grupi i ekspertëve të komunikacionit shumën prej 600.00€, për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 100.00-€.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan,

Departamenti i Përgjithshëm.

C.nr.804/2020 me datën 15.01.2024

Gj y q t a r i

Zenel Tasholli

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë(15) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.